



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 9.4.2024

Nr: 33

Ora: 12:00

**VENDIM
PËR**

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË BERAT, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E KOALICIONIT “BASHKË
FITOJMË”, ZJ. KLEJDA MILTIADH KUSTA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 149/1 prot., datë 13.02.2024, Këshilli i Bashkisë Berat, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Petrit Leme Sinaj, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë.”

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për Këshillin e Bashkisë Berat, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 8, zj. Klejda Miltiadh Kusta.

Me shkresën nr. 479, prot., datë 19.2.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Berat, zj. Klejda Miltiadh Kusta, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Këshillin Bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër BR-BF-3963_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i Këshilltarit të Bashkisë.

Data: 9.4.2024 Nr: 33
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Klejda Miltiadh Kusta”

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Klejda Miltiadh Kusta, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 553 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile dhe me shkresën nr. 551 prot., datë 26.02.2024, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Gjyqësore për zj. Klejda Miltiadh Kusta.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 2452/1 prot., datë 6.3.2024 ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Klejda Miltiadh Kusta, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3084/1 prot., datë 4.3.2024, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Klejda Miltiadh Kusta, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Klejda Miltiadh Kusta, në Këshillin e Bashkisë Berat, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Berat, me kandidatin nga lista shumemërore e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”, zj. Klejda Miltiadh Kusta.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI